

ANALIZA VJETORE 2024





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORIA RAJONALE E TRASHËGIMISË KULTURORE GJIROKASTËR

Nr. _____ prot.

Gjirokastrë, më 09.01.2024

Lënda: Analiza e vitit 2024 e Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Gjirokastrë.

MINISTRISË TË EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
Rruga “Dëshmorët e 4 Shkuriti”, Tiranë

Bashkalidhur po ju dërgojmë analizën vjetore për vitin 2024, të Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Gjirokastrë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

DREJTORI

ARDIS DUKA

Adresa: Rruga Dr.Vasil Laboviti Nr. 3, Lagjia Varosh, Gjirokastrë, Shqipëri.
Tel: +355 84 26 9001 E-mail: drtkgjirokaster@meki.gov.al



TABELA PËRMBLEDHËSE

1. SEKTORI E ARKEOLOGJISË ARKITEKTURËS ARTIT DHE MENAXHIMIT TË TRASHËGIMISHË KULTURORE.	4
1.1. Trashëgimia Materiale	4
1.2. Trashëgimia jomateriale.	17
2. SEKTORI I FINANCËS DHE SHRBIMEVE MBËSHTETËSE.	23
3. SEKTORI I MENAXHIMIT TË PARQEVE ARKEOLOGJIKE (ANTIGONE ADRIANOPOLIS)	27
4. PROJEKTET E HUAJA	29
5. PROBLEMATIKAT GJATË VITIT 2024.	29
6. OBJEKTIVAT PËR 2025.	30

LISTA PËRMBLEDHËSE e TABELAVE DHE FIGURAVE

Table 1 Tabela me ndërhyrjet mirëmbajtjtëse në objektet Monument Kulture.	6
Table 2 Tabela e ndërhyrje emergjente për heqjen e rrezikshmërisë	11
Table 3 Tabela e punimeve të pastrimit nga vegjetacioni	13
Table 4 Tabela me objektet e riskut për vitin 2025	14
Table 5. Aktivitete në fushën e trashëgimisë jomateriale	17
Table 6 Tabela e Realizimit të Buxhetit për vitin 2024	23
Table 7 Tabela krahasimore e realizimit të të ardhurave	24
Table 8 Fluksi i vizitoreve në kalanë e Gjirokastrës	24
Table 9 Tabela e fluksit të Lëvizjes të vizitorëve në parakun e Antigonesë	25
Table 10 Trajnimi i stafit	26
Table 11 Nderhyrje mirembajtese të kryera nga sektori i parqeve arkeologjike	27
Figure 1 Kisha e Manastirit të Shpërfytyrimit, Çatistër	31
Figure 2 Ura e Kordhocës.	32
Figure 3 Ura e Fshatit Bënjë	32
Figure 4 Ura e Zerzebilit	32
Figure 5 Kalaja e Kardhiqit	33
Figure 6 Bendi i Nokoves, Mingulit , Kellezit	34
Figure 7 Kulla e Sahatit Lihohove	34
Figure 8 Objekt në qendren historike Gjirokastrës	34
Figure 9 Ura e Zonjes, Kacarelos, Ciminxhit	36
Figure 10 Porta në Qendren historike Gjirokastrës	36

Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Gjirokastrë në zbatim të ligjislacionit dhe detyrave të saj gjatë 12-mujorit “01 Janar 2024- 31 Dhjetor 2024” ka realizuar këto objektiva:

1. SEKTORI E ARKEOLOGJISË ARKITEKTURËS ARTIT DHE MENAXHIMIT TË TRASHËGIMISHË KULTURORE.

1.1. Trashëgimia Materiale

- ❖ Në sektorin e AAAMTK-së, gjatë vitit 2024 është punuar kryesisht në mirëmbajtjen e monumnteve, pastrimin e tyre nga vegjetacioni, duke shpëtuar nga shkatërrimi një pjesë të madhe të tyre. Gjatë këtij viti duke qëndruar në korrent për cdo problem të evidentuar, nuk kemi pasur asnjë shkatërrim në objektet monument kulture.
- ❖ Sistemi i krijuar në institucionin tonë, me gjurmimin e problematikave në objektet e braktisura, ka bërë që ato të evidentohen në kohë dhe të merren masa. Bashkëpunimi me pronarët ka qënë i frytshëm, duke iu përgjigjur kërkesave të tyre në kohë. Ky bashkëpunim konsiston në faktin që në riparimin e monumnteve, një pjesë e madhe e materialeve të vendosura, janë nga vetë pronarët.
- ❖ Gjatë vitit 2024, pjesën më të madhe të punës ia kemi kushtuar riparimit dhe mirëmbajtjes së banesave në qytetin e Gjirokastrës.
- ❖ Konkretisht, kemi restauruar rreth **40 objekte** monument kulture, banesa. Punimet kryesore konsistojnë në restaurim catie, fasada, duke hequr rrezikshmerine e tyre.
- ❖ Gjithashtu, prioritet ka qënë dhe mirëmbajtja e portave karakteristike, pjesë e monumnteve dhe ato që janë monument kulture më vete. Janë restauruar rreth **15 porta**, të cilat kanë pasur problem me catinë dhe kanatet. Në restaurimin e tyre jemi munduar të ruajmë sa me shumë pjesë origjinale, duke i dhënë jetë këtyre pjesëve\

Gjatë vitit 2024 është ndërhyrë në mirëmbajtje, restaurim dhe heqje të rrezikshmërisë në **10 objekte** kulti të shpërndara në Gjirokastrë, Tepelenë, Përmet. Mirëmbajtja e këtyre objekteve, dukje u kujdesur për ruajtjen e origjinalitetit, ka qënë prioritet i specialistëve tanë.

- ❖ Aktivitet tjetër i rëndësishëm ka qënë mirëmbajtja e kalave dhe e parqeve që administrojnë institucioni ynë. Rritja e fluksit të turistëve në Kalanë e Gjirokastrës, kërkoi një angazhim të madh të punonjësve tanë. Gjatë këtij viti, një pjesë e personelit, ka punuar në kala për mirëmbajtjen, pastrimin dhe rrethime të ndryshme për sigurimin e vizitorëve. Mirëmbajtja e objekteve të shërbimit, sinjalistika dhe siguri i lëvizjes së turistëve ka qënë në qëndër të vëmendjes sonë. Nuk kemi pasur asnjë incident apo reklamim të punës sonë. Mbajtja pastër e objekteve monument kulture edhe në sitet e tjera, si në Antigone, Adrianopol, ka qënë gjithashtu prioritet për ne.
- ❖ Me rëndësi të vecantë ka qënë dhe pastrimi nga vegjetacioni. Gjatë këtij viti kemi pastruar nga vegjetacioni i ulet dhe i lartë **10 objekte**, si kala, ura dhe objekte kulti të braktisura. Duke përdorur metodën e bashkëpunimit me pronarët, të cilët me dëshirën e tyre kanë vendosur bazën materiale për restaurimin e objekteve, kemi minimizuar kostot.
- ❖ Gjatë këtij viti, vlera e materialeve të vendosura në gjithë objektet e restauruara ishte **132.619 lekë**.

- ❖ Sektori AAAMTK gjatë vitit 2024 ka pasur një punë të ngjeshur në procesin e projektimit, konstatimit, kolauduimit dhe kontrollit të punimeve të kryera.
- ❖ Janë hartuar 18 projekte restaurimi si dhe kemi bashkëpunuar në 4 projekte të tjera. Gjatë vitit janë kryer rreth 100 Akt Konstatime, kemi ndjekur, kontrolluar dhe çertifikuar rreth 12 objekte dhe jemi në vazhdimësi .
- ❖ Gjatë këtij viti kemi kontrolluar dhe verifikuar të gjitha objektet e katetegorise së I-rë dhe të II-të në qytetin e Gjirokastrës duke freskuar dhe përditësuar kartelat që mungonin.
- ❖ Plotësimi i dokumentacionit për ndërhyrjet e realizuara ka qenë dhe është prioriteti ynë. Dokumentimi, fotografimi, Akt Konstatimi për të gjitha objektet e inspektuara ka qenë pjesë e punës sonë të përditshme.
- ❖ Kthim përgjigjet e kërkesave të qytetarëve kanë qenë në kohën e duhur dhe të dokumentuara në të gjitha rastet. Gjatë këtij viti kemi kontrolluar dhe çertifikuar 10 objekte të cilat kanë fituar bonusin e rijetësimit për restaurimin e tyre. Këto objekte kanë qenë financim i Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe kemi qenë në gatishmëri për plotësimin me të gjitha parametrat e nevojshme të projektit Kontrolli i vazhdueshëm gjatë zbatimit të punimeve ka qenë efikas për përfundimin e tyre në kohë dhe me cilësi.
- ❖ Risi në Sektorin tonë është dhe pjesmarrja në projektim dhe miratimi i një projekti gërmim shpëtimi në Arkeologji falë kjo dhe nga plotësimi e një specialisti të munguar në sektorin tonë që është i specializuar dhe në fushën e arkeologjisë.
- ❖ Me rëndësi është të theksojmë dhe faktin se gjatë vitit 2024, nga ana e DRTK Gjirokastrë, u mundësua realizimi I projekteve, financimi dhe kryerja e ndërhyrjes restaurues dhe shpëtuese për katë objekte shumë të rëndësishëm, të cilët paraqesnin rrezikshmëri për dëmtim dhe rrënim. Ato janë:
 - Restaurim I Urës së Kordhocës, Faza e dytë, realizuar me një fond prej 4.924.386 lekë.
 - Restaurimi I Urës së Bënjës., Përmet, realizuar me nje fond prej 1.620.000 lekë.
 - Restaurimi I Urës së Zerzeblit në Gjirokastrë, me një fond prej 1.554.192 lekë
 - Restaurimi I Kishës së Manastirit të Shpërfytyrimit në Catistë, me një fond prej 2.013.696 lekë.
- ❖ Gjatë këtij viti në bashkëpunim me CHëB ka filluar restaurimi I 4 katër objekteve si më poshtë:
 - Manastiri I Dhuvjanit.
 - Manastiri I Vanistrës.
 - Kisha e Profetit Ilia në Buhal, Përmet.
 - Kisha e Shën Nikollës, Dhuvjan.
- ❖ Gjatë vitit 2024 instituti Kombëtar I Trashëgimisë Kulturore ka filluar ndërhyrjen restauruese në 6 (Gjashtë) objekte si më poshtë:
 - Ura e Grapshit
 - Ura e Haskovës
 - Banesa Fico
 - Banesa Angonatët
 - Banesa e Myfit Beut, Libohovë
 - Manastiri I Shën Mëris, Spile Saraqinishtë Gjirokastrë.

Adresa: Rruga Dr.Vasil Laboviti Nr. 3, Lagjia Varosh, Gjirokastrë, Shqipëri.

Tel: +355 84 26 9001 E-mail: drtkgjirokastrer@meki.gov.al



Objektet në të cilat është ndërhyrë gjatë vitit 2024 janë sipas tabelës mëposhtë:

Table 1 Tabela me ndërhyrjet mirëmbajtëse në objektet Monument Kulture.

N r.	Emërtimi i Objektivit	Periudha	Vlera e Financimit	Produkti i Përfutur
Mirëmbajtje rutinë në objekte				
	Mirëmbajtje dhe restaurimbanesa “Selam Musait”, fshati Salari, (Monumenti kategorisë së I-rë), Bashkia Tepelenë.	Janar	6,720.00	Realizimi i ndërhyrjes, mundëson ruajtjen dhe shpëtimin e çatisë nga degradimi dhe demtimi i metejshëm
2	Mirëmbajtje dhe restaurimTeqeja Koshtan Tepelenë , (Monument I kategorisë së I-rë), Tepelenë.	Janar	792.00	Realizimi i ndërhyrjes, mundëson ruajtjen dhe shpëtimin e kornizës së çatisë nga degradimi dhe demtimi i metejshëm
3	Mirëmbajtje dhe restaurimne Parkun Arkeologjik Antigone, Gjirokastrë.	Janar		Pastrim nga vegjetacioni , si dhe shërbime në ngritjen e mureve dhe sistemit të ambjentëve rreth monumenteve në Agora dhe Bllokun e banesave për t’i rritur pamjen vizuale.
4	Mirëmbajtje dhe restaurimbanesa “Suti”, lagjja Palorto, (Monumenti kategorisë së II-të), Gjirokastrë.	Shkurt		Realizimi i ndërhyrjes, mundëson ruajtjen dhe shpëtimin e çatisë nga degradimi dhe demtimi i metejshëm
5	Mirëmbajtje dhe restaurim porta “Harshova”, lagjja Varrosh, (Monumenti kategorisë së II-të), Gjirokastrë.	Shkurt		Realizimi i ndërhyrjes, mundëson ruajtjen dhe shpëtimin e çatisë së portës nga degradimi dhe demtimi i metejshëm
6	Mirëmbajtje dhe restaurimbanesa “Gudha”, lagjja Meçite, (Monumenti kategorisë së II-të), Gjirokastrë.	Mars	20,374.00	Realizimi i ndërhyrjes, mundëson ruajtjen dhe shpëtimin e spërthit të çatisë nga degradimi dhe demtimi i metejshëm.
7	Mirëmbajtje dhe restaurimbanesa “Skënduli”, lagjja Palorto, (Monumenti kategorisë së I-rë), Gjirokastrë.	Mars		Realizimi i ndërhyrjes, në bashkëpunim me poseduesin e pronës mundëson ruajtjen dhe shpëtimin e spërthit të çatisë nga degradimi dhe demtimi i metejshëm.
8	Punime mirëmbajtje banesa “ A. Meleqi”, lagjja Pazar I Vjeter, (Monumenti kategorisë së II-të), Gjirokastrë.	Prill		Realizimi i ndërhyrjes, mundëson ruajtjen dhe shpëtimin e çatisë nga degradimi dhe demtimi i metejshëm
9	Punime mirëmbajtje në Pazarin Karakteristik ,Blloku nr.4, Gjirokastrë.	Prill		Realizimi i ndërhyrjes, mundëson ruajtjen dhe shpëtimin e çatisë nga degradimi dhe demtimi i metejshëm dhe rregullimin e peisazhit për fillim sezoni turistik.

Adresa: Rruga Dr.Vasil Laboviti Nr. 3, Lagjja Varosh, Gjirokastrë, Shqipëri.

Tel: +355 84 26 9001 E-mail: drtkgjirokastrer@meki.gov.al



10	Punime mirëmbajtje banesa “Zekatet”, lagjja Palorto, (Monumenti kategorisë së I-rë),Gjirokastër.	Prill		Realizimi i ndërhyrjes, mundëson ruajtjen dhe shpëtimin e çatisë nga degradimi dhe demtimi i metejshëm
11	Punime përgatitore te rrethimit te Kalase Gjirokastër	Prill		Janë përgatitur kangjellat për rrethimin në ambientet e brendshme të Kalasë, për ruajtjen e sigurisë së vizitorëve.
12	Përgatitja dhe vendosja e portës së jashtme të objektit “Jetimore” lagjja “Palorto”, (Monumenti kategorisë së II-të),Gjirokastër.	Prill		Është vendosur porta e jashtme në ambientet e jetimores, Gjirokastër, për sigurimin e jetës së fëmijëve.
13	Vendosja e tabelave orientuese në Parkun Antigone	Prill	1,707.84	Realizimi i ndërhyrjes, mundëson ruajtjen dhe orientimin e kalimtareve.
14	Restaurim Porta “CALI” në lagjen Palorto.	Maj	1,505.60	Është restauruar porta me elementet e saj, pasi ishte drejt shkatërrimit.
15	Restaurim streha e spërthit të catise së objektit “Edip Aliko” në lagjen Hazmurat.	Maj	1,936.80	Restaurimi i spërthit shpëton catinë dhe veranden nga degradimi.
16	Restaurim i catise së objektit “Puto-Galaxhi-Drrasa”.	Maj	1,573.04	Restaurimi i catise së objektit, shpëton objektin nga degradimi i metejshëm.
17	Restaurim muri dhe pllakat e kanaleve të ujërave të shiut në Kalanë Gjirokastër	Maj	2,220.00	Sistemim dhe restaurim të disa mureve, si dhe pllakave të cilat mbulojnë kanalizimet e ujërave të shiut në Kalanë Gjirokoaster, demtuar nga mjetet dhe vizitorët.
18	Restaurim porta e Baneses “Denisa Peshë” në lagjen Palorto.	Maj	3,360.00	Ndërhyrje në elementet dhe strukturën e portës, për të shpëtuar nga demtimi i metejshëm dhe sistemimin e saj.
19	Restaurim i sheshit në hapësirën e brendshme të Kishës së Shen Kollit në Saraqinishtë	Maj	1,500.00	Heqje, sistemim dhe rivendosje e pllakave të gurit në ambientet e brendshme të sheshit të Kishës së Shen Kollit në Saraqinishtë.
20	Restaurim porta e objektit “Karagjozi” në lagjen Dunavat.	Maj	3,564.80	Restaurimi i portës dhe elementeve të saj, mbasi ishin të demtuara nga lageshtira.
21	Ndërhyrje restauruese banesa “Drasa” lagjia “Mecite” (Monument Kulture Kategorisë së II(dytë)).	Qershor		Gjatë këtij muaji DRTK Gjirokastër ka realizuar ndërhyrje restauruese në spërthinë e banesës “Drasa” në bashkëpunim me pronarin i cili ka vendosur materiale.

Adresa: Rruga Dr.Vasil Laboviti Nr. 3, Lagjia Varosh, Gjirokastër, Shqipëri.
Tel: +355 84 26 9001 E-mail: drtkgjirokastr@meki.gov.al



22	Ndërhyrje restauruese banesa “Jupi” lagjia “Mecite” (Monument Kulture Kategoritë e II(dytë)).	Qershor		Gjatë këtij muaji DRTK Gjirrokastër ka realizua ndërhyrje restauruese në spërthin e banesës “Jupi” ecila kishte probleme me spërthin në pjesën ballore të saj. Kjo ndërhyrje u realizua në bashkëpunim me pronarin i cili ka vendosur materialet.
23	Ndërhyrje restauruese banesa “Kasi” lagjia “Palorto” (Monument Kulture Kategoritë II(dytë)).	Qershor		Gjatë këtij muaji DRTK Gjirrokastër ka realizuar ndërhyrje restauruesen në spërthin e catisë të banesës “Kasi” në bashkëpunim me pronarin i cili ka vendosur materialet.
24	Ndërhyrje restauruese porta e banesës “Muzina” lagjia “Palorto” (Monument culture kategoritë e II(dytë)).	Qershor		Gjatë këtij muaji DRTK Gjirrokastër ka realizuar ndërhyrje restauruese në catinë e portës “Muzina” e cila kishte demtime në konstruksion. Kjo ndërhyrje u realizua në bashkëpunim me pronarin i cili vendosi pjesën e materialeve të nevojshme.
25	Ndërhyrje restauruese porta “Ballo” lagjia “Palorto” (Monument Kulture Kategoritë e II(dytë)).	Qershor		Gjatë kësaj jave DRTK Gjirrokastër ka realizuar ndërhyrje restauruese në kanatet e portës së banesës “Ballo” të cilat ishin kalbur dhe u zëvendësuan me të reja.Kjo ndërhyrje u realizua në bashkëpunim me pronarin i cili vendosi një pjesë të materialeve.
26	Ndërhyrje restauruese porta “Kocollari” lagjia “Mecite” (Monument Kulture Kategoritë e II(dytë)).	Qershor		Gjatë këtij muaji DRTK Gjirrokastër ka fillua punën për ndërhyrje restauruese në portën jashtme të banesës “Kocollari” e cila ka probleme me catinë si dhe kanatet e portës të cilat do restaurohen.
27	Ndërhyrje restauruese banesa “Angonatët” lagjia “Partizani” (Monument Kulture Kategoritë e I(parë)).	Qershor		Gjatë këtij muaji DRTK Gjirrokastër ka filluar punën për ndërhyrje restauruese në spërthin e catisë të banesës “Angonatët” në pjesën jug-lindore dëmtimi i të cilit rrezikon kalimtarët por edhe prish imazhin e kompleksit.
28	Ndërhyrje për sinjalistikën dhe kangjella Kala.	Qershor		Gjatë këtij muaji DRTK Gjirrokastër ka realizuar vendosjen e shkallëve të drurit në ambjentet e Kalasë si dhe vendosjen e kangjellave të drurit në ambiente të ndryshme të saj.

Adresa: Rruga Dr.Vasil Laboviti Nr. 3, Lagjia Varosh, Gjirrokastër, Shqipëri.

Tel: +355 84 26 9001 E-mail: drtkgjirrokaster@meki.gov.al



29	Ndërhyrje restauruese banesa “Qirjako Nikica” lagjia “Dunavat” (Monument Kulture kategori e I(parë)).	Korrik		Gjatë muajit është realizuar restaurimi I spretheve të catisë të kësaj banesë në bashkëpunim me pronarin.
30	Ndërhyrje restauruese objekti “Pallati i Oficerëve” lagja “Palorto”.	Korrik		Gjatë muajit është ndërhyr për restaurimin e catisë dhe spretheve të këtij objekti në bashkëpunim me pronarët.
31	Ndërhyrje restauruese banesa “Alize Kaso”,lagja “Palorto” (monument Kulture Kategori e II(dytë)).	Korrik	9,734.80	Përfunduar.
32	Ndërhyrje restauruese porta e banesës “Afrim Kaso” ,lagja “Dunavat” (Monument Kulture Kategori e II(dytë)).	Korrik		Eshtë realizuar gjatë muajit ndërhyrje restauruese në catinë e portës të kësaj banese e cila kishte problemem testekët të cila u restauruan.(Kjo punë u realizua në bashkëpunim me pronarin).
33	Ndërhyrje restauruese porta “Kocollari” lagjia “Mecite” (Monument Kulture Kategori e II(dytë)).	Korrik	2,281.20	Përfunduar.
34	Ndërhyrje restauruese në portën e banesës “Bazo” ,lagja “Palorto” (Monument Kulture Kategori e I(parë)).	Korrik	2,280.00	Eshtë realizuar gjatë muajit ndërhyrje në portën e jashtme të kësaj banesë e cila është restauruar duke ruajtur elementet e saj.
35	Punime mirmbajtje kala.	Korrik		Gjatë muajit janë realizuar punime pastime dhe mirëmbajtje në Kalanë e Gjirokastrës.
36	Ndërhyrje restauruese banesa “Zoica” lagja Palorto (Monument Kulture Katëgori e II(dytë))	Gusht		Gjatë muajit është ndërhyrë për restaurimin e sprethit të catisë së kësaj banese e cila kishte problem me rreshkitjen e rasës së gurrit si dhe thyerje te bishtave. Kjo ndërhyrje u realizua në bashkëpunim me pronarin.
37	Ndërhyrje restauruese banesa “Bicuni” lagja Varosh (Monument Kulture Kategori e II(dytë))	Gusht		Gjatë muajit u ndërhy për restaurimin e një pjesë të catisë dhe sprethit të kësaj banese e cila ishte e dëmtuar .- Kjo ndërhyrje u realizua në bashkëpunim me pronarin.
38	Ndërhyrje restauruese banesa “Sinani” lagja Pazar i Vjetër (Monument Kulture Katëgori e II(dytë))	Gusht		Gjatë muajit u ndërhy për restaurimin e catisë së kësaj banesë e cila kishte dëmtime në pjesë të ndryshme të saj. - Kjo ndërhyrje u realizua në bashkëpunim me pronarin.

Adresa: Rruga Dr.Vasil Laboviti Nr. 3, Lagjia Varosh, Gjirokastrë, Shqipëri.

Tel: +355 84 26 9001 E-mail: drtkgjirokastrer@meki.gov.al

39	Ndërhyrje restauruese porta e banesës “Ladi Shehu” lagja Manalat (Monument Kulture Kategori e II(dytë)	Gusht		Gjatë muajit u ndërhy për restaurimin e catisë së portës Shehu e cila kishte problem me qëndrueshmërinë dhe u restaurua ne total. -Kjo ndërhyrje u realizua në bashkëpunim me pronarin.
40	Ndërhyrje restauruese dhe mirmbajtje Kala Gjirokastrë.	Shtator	2,070	
41	Realizimi I koshave për mbeturina në Kalanë e Gjirokastrës ,Antigone dhe Kala Libohovë.	Shtator	21,556	
42	Ndërhyrje mirmbajtje banesa “Xhezo” Lagja Palorto (Monumen Kulture Kategori e I(parë)	Shtator		Gjatë muajit është ndërhyrë në sprethin e banesës Xhezo (Monument Kulture Kategori e I (parë) e cila kishte problem ne pjesen perendimore të saj si thyerje të bishtave dhe trarëve. -Kjo ndërhyrje u realizua në bashkëpunim me pronarin.
43	Ndërhyrje mirmbajtje banesa “Arapi” lagja Palorto.	Shtator		Gjatë muajit u ndërhy për restaurimin e sprethit ballor të catisë së kësaj banese e cila rezikonte te shembej si pasoj e thyrjes së trarit dhe bishtave.
44	Ndërhyrje restauruese banesa “Zekatët” lagja Palorto (Monumen Kulture Kategori e I(parë)	Shtator		Gjatë muajit është ndërhyrë në këtë banesë për zënien e pikave të cilat mund të dëmtonin catinë.
45	Ndërhyrje mirmbajtje banesa “Kadare” lagja Palorto (Monument Kulture Kategori e I(parë)	Shtator		Është ndërhyrë në catinë e kësaj banese për zënien e pikave.
46	Ndërhyrje resturuese në portën e banesës “Margariti” lagja Palorto.	Tetor		Ka filluar ndërhyrje për restaurimin e portës Margariti duke rruajtur elementet autentik të saj.
47	Ndërhyrje restauruese banesa “Cipi” lagja Palorto	Nëntor		Ndërhyrje restauruese në catinë e banesës Cipie cila kishte problem me një pjesë të catisë. Ndërhyrja u realizua me materialet e veta.
48	Ndërhyrje restauruese banesa “Tomor Hoxha” lagja “Pazar i Vjetër” .	Nëntor		Drk Gjirokastrë ka filluar punën për restaurimin e catisë të këtij objekti I cili ka pasur problem në një pjesë të saj .
49	Ndërhyrje restauruese porta e banesës “Këndella” lagja “Partizani”.	Nëntor	2,000.64	Ka filluar puna për restaurimin e portës së jashtme të kësaj banese e cila kishte problem në qëndrueshmërinë e saj.

Adresa: Rruga Dr.Vasil Laboviti Nr. 3, Lagjia Varosh, Gjirokastrë, Shqipëri.

Tel: +355 84 26 9001 E-mail: drtkgjirokastr@meki.gov.al



50	Ndërhyrje restauruese porta e jashtme e banesës “Baco”	Dhjetor		Në bashkëpunim me pronaret që kontribuan në vendosjen e materialeve, u realizua catia me rrasë guri dhe u restaurua porta e jashtme dyfletëshe prej druri
----	--	---------	--	---

Table 2 Tabela e ndërhyrje emergjente për heqjen e rrezikshmërisë

Ndërhyrje emergjente për heqje rrezikshmërie

1	Mirëmbajtje dhe restaurimne Kishen e Shën Dëllisë, (Monument katig. I) fshati Buhal Përmet.	Janar	7,200.00	Realizimi i ndërhyrjes, mundëson ruajtjen dhe shpëtimin e çatisë nga degradimi dhe demtimi i metejshëm
2	Mirëmbajtje dhe restaurimne Kishen e Shen Kollit, (Monument katig. I) Saraqinisht, Gjirokaster.	Janar	7,854.00	Realizimi i ndërhyrjes, mundëson ruajtjen dhe shpëtimin e çatisë nga degradimi dhe demtimi i metejshëm
3	Ndërhyrje restauruese"Manastiri I Mingulit", fshati Mingul (Monument i kategorisë së I-rë),Gjirokastër	Janar		Realizimi i ndërhyrjes,mundëson ruajtjen dhe shpëtimin e çatisë së portësnga degradimi dhe demtimi i metejshëm.
4	Mirëmbajtje dhe restaurimbanesa “Sulo Llaqi”,lagjja Manalat, (Monumenti kategorisë së I-rë),Gjirokastër.	Janar		Realizimi i ndërhyrjes,mundëson ruajtjen dhe shpëtimin e çatisë nga degradimi dhe demtimi i metejshëm
5	Mirëmbajtje dhe restaurimbanesa Ciu "Margarita Haloci",lagjja Dunavat, (Monumenti kategorisë së I-rë),Gjirokastër.	Janar		Realizimi i ndërhyrjes,mundëson ruajtjen dhe shpëtimin e çatisë nga degradimi dhe demtimi i metejshëm
6	Mirëmbajtje dhe restaurim në Bllokun e dytë pjesë e Pazarit Karakteristik, (Monumenti kategorisë së I-rë),Gjirokastër.	Shkurt		Realizimi i ndërhyrjes, në bashkëpunim me Myftyninë, mundëson ruajtjen dhe shpëtimin e çatisë nga degradimi dhe demtimi i metejshëm.
7	Mirëmbajtje dhe restaurimbanesa ‘Zekatët",lagjja Palorto, (Monumenti kategorisë së I-rë),Gjirokastër.	Shkurt		Realizimi i ndërhyrjes,mundëson ruajtjen dhe shpëtimin nga lagështia pjesën e tavanit si dhe fiksimin e një pjese të dritareve të banesës.
8	Mirëmbajtje dhe restaurimne Kishen e Shen Mërisë, (Monument katig. I) fshati Labovë e Kryqit, Gjirokaster.	Shkurt	1,839.60	Realizimi i ndërhyrjes,mundëson ruajtjen dhe shpëtimin e çatisë së portës nga degradimi dhe demtimi i metejshëm.

Adresa: Rruga Dr.Vasil Laboviti Nr. 3, Lagjia Varosh, Gjirokastër, Shqipëri.

Tel: +355 84 26 9001 E-mail: drtkgjirokaster@meki.gov.al



9	Punime mirëmbajtje banesa “Mezini”, lagjja Pazar I Vjeter, (Monumenti kategorisë së II-të),Gjirokastër.	Prill	11,775.20	Realizimi i ndërhyrjes,mundëson ruajtjen dhe shpëtimin e sprehit të çatisë nga degradimi dhe demtimi i metejshem
10	Punime mirëmbajtje banesa “ Kuci”, lagjja Pazar I Vjeter, (Monumenti kategorisë së II-të),Gjirokastër.	Prill	595.80	Realizimi i ndërhyrjes,mundëson ruajtjen dhe shpëtimin e sprehit të çatisë në pjesën jugore nga degradimi dhe demtimi i metejshem
11	Punime mirëmbajtje Porta “ Kurti”, lagjja Cfakë, (Monumenti kategorisë së I-rë),Gjirokastër.	Prill		Realizimi i ndërhyrjes, mundëson ruajtjen dhe shpëtimin e portës nga degradimi dhe demtimi i metejshem
12	Ndërhyrje restauruese banesa “Alize Kaso”, lagjja “Palorto” (Monument Kulture Kategori e II (dytë).	Qershor		Gjatë këtij muaji Drtk Gjirokastër ka ndërhyrë për restaurimin e një pjese tëcatisë të banesës “Kaso” e cila rrezikonte shembjen.
13	Ndërhyrje restauruese në Manastirin e “Shën Qirjakut dhe Julitës”,fshatin Dhuvjan, Dropull.	Korrik	1,773.83	Eshtë realizuar gjatë muajit pajantimi I mureve të këtij objektui kulti (Monument Kulture Kategori e I(parë).
14	Ndërhyrje restauruese në kishën e Shën Dëllisë” Buhal/Përmet (Monument Kulture Kategori e I(parë)	Shtator		Ka filluar puna gjatë muajir për restauruar hajatn e catisë së kësaj kishë e cila kishte problem të konsiderueshme me qëndrueshmërinë.
15	Ndërhuyrje mirmbajtje banesa “Ciu” lagja Dunavat (Monument Kulture Kategori e I(parë).	Shtatot		Eshtë ndërhyrë tek kjo banesë për zënien e pikave të cilat dëmtonin më tej banesën.
16	Ndërhyrje restauruese catia e banesës “Sami Kotro” , lagja Varosh, Qendra Historike”	Tetor		Eshtë ndërhyr gjatë muajit për restaurimin e nje pjese të catisë të kësaj banesë e cila rezikonte kalimtarët pasi ndodhej në një zonë të populluar pranë Qendrës Muzeale dhe afër Shkollës Artistike “Feim Ibrahim”
17	Ndërhyrje mirmbajtje në banesën Martin Cici ,lagja Palorto.	Tetor		Është ndërhyrë gjatë muajit në catinë e këtij objekti e cila kishte shfaqur problem me qëndrueshmërinë.
18	Ndërhyrje emergjente banesa “Duka” lagja Varosh.	Tetor		Heqje rezikshmërie ne catinë e kësaj banese e cila rezikonte kalimtarët por edhe vetë banorët e banesës.
19	Ndërhyrje emergjente banesa “Andoni” lagja 11 Janari.	Tetor		Heqje rezikshmërie në objektin Andoni pazi rezikonte kalimtarët dhe banorët e bllokut të banesave ngjitur me të.

Adresa: Rruga Dr.Vasil Laboviti Nr. 3, Lagjja Varosh, Gjirokastër, Shqipëri.

Tel: +355 84 26 9001 E-mail: drtkgjirokaster@meki.gov.al



20	Ndërhyrje restauruese banesa “Cico” lagja Hazmurat	Nëntor		Eshtë ndërhyr për zënien e pikave dhe shmangine e degradimit të pjesës jug-perëndimore të objektit
21	Ndërhyrje restauruese në catinë e banesës “Jace Hasko” lagja Dunavat.	Nëntor		Drtk Gjirokastrë ka ndërhyrë gjatë muajit për restaurimin e një pjese të banesës Hasko e cil kishte shfaqur problem me një pjesë të catisë e cila pikonte dhe rezikonte degradimin e më tejshëm. Ndërhyrja u realizua me materialet e veta.
22	Heqje rezikshmërie Banesa “Duka” lagja Palorto.	Nëntor		Drtk Gjirokastrë ka ndërhyrë për heqjen e rezikshmërisë në banesën Duka si pasojë e rreshkitjes së rasës së gurit.
23	Ndërhyrje mirëmbajtje Banesa “Çiço”, lagja “Hazmurat”	Dhjetor	675.00	U restaurua një pjese e catise e cila kishte probleme me mahite dhe petavra te demtuara
24	Ndërhyrje emergjente mirembajtje Banesa “Ciu”, Lagja “Dunavat”	Dhjetor	2,593.80	U realizua pajantimi I një pjese te catise qe rrezionte shembjen

Table 3 Tabela e punimeve të pastrimit nga vegjetacioni

Pastrim nga vegjetacioni

1	Ndërhyrje mirëmbajtje ne Bendin e Nokovës, (Monum. katig. I) fshati Nokovë, Lunxheri, Gjirokastrë.	Janar		Pastrim i vegjetacionit në bendin mbi perroin e Nokovës në zonën e Lunxhërisë, për t’i rritur pamjen vizuale të saj.
2	Ndërhyrje mirëmbajtje në Bendi I Rigës (Monum. katig. I) fshati Këllëz, Gjirokastrë	Shkurt		Pastrim i vegjetacionit në bendin mbi perroin e Gurrës në fshatin Këllëz, për t’i rritur pamjen vizuale të saj
3	Mirëmbajtje dhe restaurimne Parkun Arkeologjik Antigone, Gjirokastrë.	Shkurt		Pastrim nga vegjetacioni në muret e portës jugore dhe veriore, si dhe në Zonën e Nimfeut, dhe sistemimin e ambjenteve në ngritjen e mureve dhe nxjerrja e kontureve, për t’i rritur pamjen vizuale.
4	Mirëmbajtje dhe pastrime në objektin “Naka”, lagja Palorto, (Monument I kategorisë së II-të)	Shkurt		Pastrim i vegjetacionit në objektin “Naka”, pasi kishin dëmtuar një pjesë të sprethit dhe dritaret në pjesën e pasme të saj.

Adresa: Rruga Dr.Vasil Laboviti Nr. 3, Lagja Varosh, Gjirokastrë, Shqipëri.

Tel: +355 84 26 9001 E-mail: drtkgjirokastrer@meki.gov.al



5	Mirëmbajtje dhe pastrime në monumentet “Mulliri I Nivicë” dhe banesa “ Myfit Kaçubaj” (Monumentetë kategorisë së I-rë), Tepelenë, Gjirokastrë.	Shkurt		Pastrim i vegjetacionit në dy objektet në zonën e Tepelenë, për t'i rritur pamjen vizuale të saj.
6	Mirëmbajtje dhe pastrime në Kalanë e Gjirokastrës.	Mars	15,333.36	Realizimi i ndërhyrjes, mundëson marrjen e masave mbrojtëse për riparimin e rrethimit dhe vendosja e tabelave sinjalistike në Kalanë e Gjirokastrës.
7	Mirëmbajtje dhe pastrime në Teatrin Sofratik, Hadrianopol.	Mars		Realizimi i ndërhyrjes, mundëson marrjen e masave mbrojtëse për ngritjen e mureve të dëmtuara në Teatrin Sofratik, Hadrianopol, si dhe pastrimi i vegjetacionit të monumentit, për t'i rritur pamjen vizuale.
8	Pastrimi nga vegjetacionet “ Ura e Zonjës”, fshati Suh, Libohovë, (Monumenti kategorisë së I-të), Gjirokastrë.	Prill		Pastrim i vegjetacionit në “ Urën e Zonjës” në zonën e Libohovës, për t'i rritur pamjen vizuale të saj.
9	Pastrim nga vegjetacionet Kisha e “ Shën Ilias “ , Stegopol, Libohovë, Gjirokastrë.	Prill		Pastrim i vegjetacionit në Kishën e “ Shën Ilias” Stegopol, Libohovës, për t'i rritur pamjen vizuale të saj.
10	Pastrime nga vegjetacionet në Kalanë Libohovë, Gjirokastrë.	Prill		Pastrim i vegjetacionit në Kalanë Libohovë, për t'i rritur pamjen vizuale të saj.
11	Pastrime nga vegjetacionet Kalaja Gjirokastrë.	Prill		Pastrim i vegjetacionit në oborret e brendshme të Kalasë.
12	Punime mirëmbajtjeje dhe pastrime në Kalanë Gjirokastrë	Dhjetor	1,744.00	U realizua mirëmbajtja e sistemit elektrik të jashtëm, u vendos tavani prej druri të vendqëndrimi I rojeve dhe punime të tjera në Kala

Table 4 Tabela me objektet e riskut për vitin 2025

OBJEKTET MONUMENT KULTURE NE RISK - QARKU GJIROKASTER			Statusi
Nr.	Emertimi i objektit në gjendje rrishtu	Niveli i Rrishtu	
1	KALAJA LIBOHOVE	4	Kategori e Pare

2	URA E MADHE E GURIT E KAÇARELLOS, MBI LUMIN KAÇARREL	3	Kategori e Pare
3	URA E GURIT E ÇIMINXHIT, MBI LUMIN E SOPIKUT	4	Kategori e Pare
4	KISHA E MANASTIRIT TË SHPËRFYTYRIMIT, MINGUL	4	Kategori e Pare
5	TEQJA KOSHTAN	3	Kategori e Pare
6	UJESJELLSI NE TEQEN E MELANIT	4	Kategori e Pare
7	URA E ZONJES	4	Kategori e Pare
8	URA NË SUBASH MBI LUMIN DRINO	3	Kategori e Pare
9	URA E UJËSJELLËSIT TË SOPOTIT MBI PËRROIN E BUFANAS	3	Kategori e Pare
10	URA E BECISHTIT- Tepelene	4	Kategori e Pare
11	KARAKOLLI ne Cajup	4	Kategori e Pare
12	Banesa LOLOMANI - Lagjia Pazar I Vjeter	4	Kategori e Dyte
13	Banesa LOLOMANI - Lagjia Varosh	4	Kategori e Dyte
14	Blloku Nr. 2 - Pazari Gjirokaster	3	Kategori e Pare
15	Banesa CIU	4	Kategori e Pare
16	BANESA E ANGONATËVE	4	Kategori e Pare
